



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 17, datë 27.01.2021

“PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRAT TË PROFILIT PROKUROR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 29 pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 166 pika 2, 183 pika 1 të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Numri maksimal i kandidatëve për magistratë të profilit prokuror që do të pranohen në programin e formimit fillestar të shkollës së magistraturës për vitin akademik 2021-2022 është 25 (njëzet e pesë).
2. Të njoftohen për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

